



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**

**V E N D I M**

Nr. 2 Date 08.03.2000

**PER MIRATIMIN E PROCEDURAVE TE KERKIMIT, SHQYRTIMIT DHE  
DHENIES SE LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE KONCESIONEVE PER  
PERDORIM REZERVASH UJORE DHE SHKARKIME**

Bazuar ne Nenin 6 te Ligjit Nr.8093, date 21.03.1996, " Per Rezervat Ujore", me propozim te Ministrise se Puneve Publike, Keshilli i Kombetar i Ujit

**V E N D O S I :**

1. Te miratoje projektin "Per procedurat e kerkimit, shqyrtimit dhe dhenies se lejeve, autorizimeve dhe koncensioneve per perdorim rezervash ujore dhe shkarkime", qe i bashkelidhet ketij vendimi dhe t'ia paraqese ate per miratim Keshillit te Ministrave.
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

  
**ILIR META**

**KRYETAR**

*Handwritten notes:*  
20/03/00  
Keshilli i Kombetar i Ujit



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**

**V E N D I M**

**Nr. 3 Date 08.03.2000**


**PER MIRATIMIN E KRYERJES TE NJE STUDIMI**

**“Mbi vleresimin e pasojave dhe ndikimit mjedisor shkaktuar prej shfrytëzimit  
te zhavorreve dhe rerave nga shtreterit e lumenjve, si dhe masat qe duhen  
marre per rehabilitimin e gjendjes“**

Bazuar ne Nenin 6 te Ligjit Nr.8093, date 21.03.1996, “ Per Rezervat Ujore”, me propozim te Ministrise se Puneve Publike, Keshilli i Kombetar i Ujit

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e kryerjes se nje studimi “Mbi vleresimin e pasojave dhe ndikimit mjedisor shkaktuar prej shfrytëzimit te zhavorreve dhe rerave nga shtreterit e lumenjeve, si dhe masat qe duhen marre per rehabilitimin e gjendjes“.
2. Faza e pare e ketij studimi te kete per objekt lumenjte Ishem dhe Erzen.
3. Ngarkohen Ministria e Puneve Publike, Ministria e Bujqesise & Ushqimit, Ministria e Ekonomise Publike & Privatizimit dhe Sekretariati Teknik i KKU, qe brenda nje muaji nga marrja e ketij vendimi, nepermjet institucioneve te tyre studimore, te hartojne projektin per fazen e pare te studimit.
4. Ngarkohet Ministria e Puneve Publike qe pas dorezimit te ketij projekti, te dergoje per miratim ne Keshillin e Ministrave, nje projekt-vendim per financimin e tij.
5. Bazuar ne konkluzionet e fazes se pare te studimit, Keshilli Kombetar i Ujit te vendose per ecurine e metejshme te ketij studimi.
6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

  
**ILIR META**

**KRYETAR**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**

**V E N D I M**

Nr. 4 Date 08.03.2000

**PER MIRATIMIN E DY PROJEKT-LIGJEVE**

“PER DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR.8093, DT.21.03.1996 "PER REZERVAT UJORE" ”  
DHE  
“PER NJE NDRYSHIM NE LIGJIN NR.8408, DT.25.09.1998 "PER POLICINE E NDERTIMIT”

Bazuar ne Nenin 6 te Ligjit Nr.8093, date 21.03.1996, “ Per Rezervat Ujore”, me propozim te Ministrise se Puneve Publike, Keshilli i Kombetar i Ujit

**V E N D O S I :**

1. Te miratoje dy projekt-ligjet:

- “Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.8093, dt.21.03.1996 "Per Rezervat Ujore" ” dhe
- “Per nje ndryshim ne Ligjin Nr.8408, dt.25.09.1998 "Per Policine e Ndertimit”,

qe i bashkelidhen ketij vendimi dhe t’ia paraqese ato per miratim Keshillit te Ministrave.

2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**ILIR META**

**KRYETAR**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**

**V E N D I M**

Nr. 5 Date 08.03.2000

**“PER KRIJIMIN E GRUPIT TE PUNES PER SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT  
TE LEJEVE TE DHENA PER SHFRYTEZIM ZHAVORRESH E RERASH NGA  
SHTRETERIT E LUMENJVE”**

Bazuar ne nenin 6 te Ligjit Nr.8093, dt.21.03.1996 "Per Rezervat Ujore", me propozim te Ministrise se Puneve Publike, Keshilli Kombetar i Ujit

**VENDOSI :**

1- Krijimin e grupit te punes me perfaqesues nga Ministria e Puneve Publike, Ministria e Ekonomise Publike & Privatizimit, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Sekretariati Teknik i K KU, per shqyrtimin dhe evidentimin e dokumentacionit te lejeve te dhena per shfrytezim zhavorresh e rerash nga shtreterit e lumenjve.

Grupi i punes, pas shqyrtimit dhe evidentimit te ketij dokumentacioni, brenda 1 muaji nga data e hyrjes se fuqi te ketij vendimi, te pergatise materialet e nevojshme dhe modalitetet per kontrollin e aktivitetit te shfrytezimit faktik te zhavorreve dhe rerave, ne gjithe territorin e Republikes.

- Ngarkohen Ministri i Puneve Publike, Ministri i Ekonomise Publike & Privatizimit dhe Ministri i Pushtetit Lokal te nxjerrin nje urdher te perbashket mbi perberjen dhe detyrat e ketij grupi.

2- Ngarkohet Ministri i Puneve Publike qe, bazuar ne materialin e mesiperem, te inicioje nje projekt- vendim per Keshillin e Ministrave per kontrollin e aktivitetit te shfrytezimit te zhavorreve ne shtreterit e lumenjve.

3- Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

  
**ILIR META**

**KRYETAR**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KESHILLI KOMBETAR I UJIT

#### VENDIM

Nr. 7 Date 18.04.2000

#### PER DHENIEN E DY LEJEVE TE VECANTA PER SHFRYTEZIM ZHAVORRESH LUMI, SI PERJASHTIM NGA VENDIMI NR. 3, DATE 04.06.1998 I KESHILLIT KOMBETAR TE UJIT

Bazuar ne Nenin 6 te Ligjit Nr. 8093, date 21.03.1996, "Per Rezervat Ujore", me propozim te Ministrise se Transportit, Keshilli Kombetar i Ujit


#### VENDOSI:

1. Te perjashtoje nga vendimi Nr. 3, date 04.06.1998 i Keshillit Kombetar i Ujit "Per pezullimin e dhenies se lejeve per shfrytezimin e zhavorreve e rerave si materiale inerte nga shtreterit e lumenjve", shoqerite "BE-HA-SE" dhe "ITALSTRADE" dhe te miratoje per to leje per shfrytezim zhavorresh lumi per ndertim rrugesh nacionale ne zonat si vijon:
  - a- Shoqerise "BE-HA-SE", qe punon per ndertimin e segmentit rrugor Rrogozhine-Elbasan, i akordohet leje per shfrytezimin e zhavorreve, deri ne perfundim te kontrates, ne shtratin e lumit Shkumbin, ne dy zonat e percaktuara ne hartat nr.1 dhe nr.2 me shkalle 1:10 000, bashkelidhur ketij vendimi.
  - b- Shoqerise "ITALSTRADE", qe punon per ndertimin e segmentit rrugor Vore-Sukth, i akordohet leje per shfrytezimin e zhavorreve, deri ne perfundim te kontrates, ne shtratin e lumit Terkuze, ne zonen e Zall Herrit, percaktuar ne harten nr.3 me shkalle 1:10 000, bashkelidhur ketij vendimi.
2. Me qellim qe te mos pengohet avancimi i punimeve ne segmentet rrugore qe ndertojne shoqerite e siperpermendura, lejohet qe keto shoqeri, te fillojne shfrytezimin e ketyre zonave per zhavorre duke filluar prej dates 20.04.2000.

3. Per ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi, ngarkohen:

- Sekretariati Teknik i K KU
- Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit
- Ministria e Transportit
- Ministria e Puneve Publike
- Ministria e Pushtetit Lokal
- Agjensia Kombetare e Mjedisit

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.



ILIR META

KRYETAR